




REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-1350/14 Prot No.
Nr. I faq. Broj stranica 04	Data Datum 16-04-2014 Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	16.04.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abaz FONIQI Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Klinës
CC:	z. Sokol BASHOTA Kryetar i Komunës së Klinës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim-montim i xhamave në objektet shkollore dhe institucioneve tjera "



I nderuari z. FONIQI ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin me titull " Furnizim-montim i xhamave në objektet shkollore dhe institucioneve tjera ", me nr. të prokurimit: 634-14-008-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull "Furnizim-montim i xhamave në objektet shkollore dhe institucioneve tjera" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04- L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Klinës ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull “Furnizim-montim i xhamave në objektet shkollore dhe institucioneve tjera” me nr. prokurimi: 634-14-008-121, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 18.03.2014, në Procedurën e Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit për këtë procedurë të prokurimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Komuna e Klinës si Autoriteti Kontraktues këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka paraparë në planifikimin e prokurimit për vitin 2014. Legjislacioni në fuqi, mundëson që aktivitet e prokurimit që nuk janë paraparë për vitin përkatës fiskal, mund të prokurohen nëse për të njëjtin prokurim Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) do të dërgojë tek Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku 5 ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për iniciimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. Përkundër kësaj procedure e cila është obligative për aktivitetet e prokurimit të cilat nuk kanë qenë të planifikuara për vitin fiskal përkatës, Autoriteti kontraktues nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta dërguar një kopje të kësaj Deklarate në Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek pika III.2.4) e rubrikës Kapaciteti teknik dhe profesional pika.2 është kërkuar që Operatori duhet të ketë seli apo njësi në territor të Klinës jo më larg se 25 km.

Autoriteti Kontraktues me formulimin e këtij kriteri tek rubrika Kapaciteti teknik dhe profesional pika.2 e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“, duke e caktuar një kufizim të tillë, favorizohen Operatorët Ekonomik që janë brenda këtij perimetri dhe në të njëjtën kohë diskriminohen OE që janë më larg se 25 km dhe, si pasojë e këtij kufizimi Operatorëve tjerë ekonomik nuk u ofrohet mundësia e barabartë që të ofertojnë dhe të jenë pjesë e konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar tërë dokumentacionin lidhur me këtë Procedurë të Prokurimit pasi Autoriteti kontraktues ka përfunduar procesin e vlerësimit të tenderëve. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet, duke u bazuar në Procesverbalin e OE që e kanë tërhequr Dosjen e Tenderit dhe Procesverbalin e OE që e kanë dorëzuar Dosjen e Tenderit, është vërejtur se numri i OE që e kanë tërhequr Dosjen e Tenderit është 9 ndërsa vetëm 2 prej Operatorëve Ekonomik i kanë dorëzuar ofertat e tyre , shumica e OE që nuk i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë kontratë janë më larg se 25 km dhe vijnë nga Komunitat tjera, me çka konstatohet shumë qartë se pikërisht kufizimi i cili është caktuar nga Autoriteti kontraktues ka bërë që shumë Operatorëve Ekonomik të mos u jepet mundësia të tenderojnë.

Duke u bazuar në Raportin e vlerësimit të Tenderëve të datës 28.03.2014 i cili është përgatitur nga Zyra e Prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar dy oferta, sipas Komisionit për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e Tenderëve i cili pasi ka përfunduar vlerësimin e tenderëve ka konstatuar dhe ardhur në përfundim se të dy OE që kanë tenderuar, janë të përgjegjshëm dhe ka propozuar që kontrata ti jepet Operatorit Ekonomik i cili është renditur në vendin e parë si oferta me çmimin më të ulët.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka ekzaminuar me kujdes ofertat origjinale të OE që kanë tenderuar për këtë kontratë, konstaton se asnjëri nga Operatorët ekonomik që i kanë dorëzuar ofertat e tyre nuk janë të përgjegjshëm, pasi që nuk i kanë plotësuar disa kërkesa të cilat janë caktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Tek pjesa e Formulari i Dorëzimit të Tenderit pika 4. është kërkuar nga OE që dorëzojnë tender ta shënojnë numrin e ditëve për të treguar se sa është valid ky tender. Lidhur me këtë pikë asnjëri nga OE nuk e kanë plotësuar këtë pikë, ndërsa Operatori i cili është renditur në vendin e dytë përveç kësaj pike nuk e ka plotësuar pikën ku është kërkuar që çmimi i tenderit të shënohet me fjalë, duke mos e plotësuar Formularin e Dorëzimit të Tenderit në mënyrë të rregullt, sipas Ligjit këta Operator konsiderohet sikur të mos kishin dorëzuar fare tender.

Në Njoftimin për Kontratë tek pika III.2.2) e rubrikës Përshtatshmëria profesionale pika 1. është kërkuar veprimtaria e cekur, ndërsa si Dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar nomenklaturë për aktivitetet të këtij shërbimi. Gjatë ekzaminimit të ofertës për Operatorin ekonomik i cili nga ana e Komisionit vlerësues është propozuar për dhënie të kontratës, AKK ka konstatuar se në Certifikatën e regjistrimit të biznesit nuk figuron veprimtaria adekuate, përmes të cilës Operatori ekonomik do ta përmbushte këtë kërkesë e cila është kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Në Dosjen e Tenderit tek rubrika Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare janë kërkuar Kontrata për punë të kryera në këtë lëmi, kërkesë kjo në kundërshtim me ligjin, pasi që Legjislacioni në fuqi e parasheh se Autoriteti kontraktues mund të caktojë një kriter të tillë të përzgjedhjes për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorit ekonomik, **por nuk lejohet në asnjë mënyrë që një kërkesë të tillë ta kërkojë për të dëshmuar aftësinë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare.**

Në Njoftimin për Kontratë tek rubrika Kapaciteti ekonomik dhe financiar është kërkuar Gjendja ekonomike e Kompanisë, ndërsa si dëshmi e kërkuar dokumentare, është kërkuar raport i bankës në periudhën vitin e kaluar 2013, apo raport auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2013, pikë kjo e cila është në kundërshtim të plotë me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik.

Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik, parasheh qartë se kërkesat për qarkullim duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me rubrikën Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe rubrikën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit mund të vërehet shumë qartë se Kriteret e përzgjedhjes të këto rubrika të cilat janë caktuar, nuk janë identike çka paraqet mospërputhje në mes Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Tek rubrika Kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale është kërkuar Staf i me kontrata të punës, Makineria e nevojshme dhe Deklarata për cilësi, lidhur me këtë kërkesë asnjëri nga Operatorët ekonomik nuk i kanë ofruar dëshmitë adekuate dhe të nevojshme të cilat janë kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Vlen të ceket se Vendimin për formimin e Komisionit për Hapjen e Tenderëve e ka nxjerr Zyrtari i Prokurimit, veprim ky i cili është në kundërshtim me LPP. Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik Zyrtari i Prokurimit ka të drejtë të propozojë përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Hapjes së Tenderëve dhe vlerësimit të Tenderëve, ndërsa aprovimin e anëtarëve të Komisionit për Hapjen e dhe vlerësimin e Tenderëve e bënë Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA).

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ekzaminoi dhe krahasoi të gjithë dokumentacionin lidhur me këtë Procedurë të Prokurimit, konstatoi dhe erdhi në përfundim se asnjëri nga Operatorët Ekonomik që kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë Kontratë nuk janë të përgjegjshëm.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi dhe nenin 8 Planifikimi i Prokurimit, nenin 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe financiare, dhe nenin 69 Aftësia teknike ose profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 8 Funkcionet e Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe nenin 10 Funkcionet e Departamentit të Prokurimit të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, dhe me nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !